



VENDIM

Nr. 6, Datë 23.04.2013

PËR PROPOZIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË DOSJES SË PROF. ASOC. ARTAN PEQINI PËR MARRJEN E TITULLIT "PROFESOR"

Senati i Akademisë së Arteve në mbledhjen e datës 23.04.2013, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse për ndryshime,

VËREN SE

Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Arteve të Bukura me Vendim të datës 11.04.2013 ka vendosur miratimin e Komisionit të Vlerësimit të Kandidatit Prof. Asoc. Artan Peqini.

Duke qenë se emrat e propozuar nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Arteve të Bukura përmbushin kriteret e përcaktuara nga VKM 467, datë 18.07.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik", i ndryshuar, si dhe duke konsideruar se në Komisione janë përfshirë edhe pedagogë të huaj, Senati Akademik e gjen propozimin të vlefshëm.

Për këtë arsye, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave sa më sipër,

VENDOSI

1. Ti propozojë KVTA miratimin e Komisionit të Vlerësimit të dosjes së Prof. Asoc. Artan Peqini për marrjen e titullit "Profesor", me përbërje si më poshtë:



i.	Prof. Fatmir Miziri	(i brendshëm)	Kryetar
ii.	Prof. Najada Hamza	(i brendshëm)	Anëtar
iii.	Prof. Ali Oseku	(i brendshëm)	Anëtar
iv.	Prof. Gazmend Leka	(i brendshëm)	Anëtar
v.	Prof. Dr. Qirjako Meniko	(i jashtëm)	Anëtar
vi.	Prof. Dr. Ferid Hudhri	(i jashtëm)	Anëtar
vii.	Prof. John Bowman	(Penn State University)	Anëtar

2. Rektori i Universitetit të Arteve i dërgon KVTA-së këtë Vendim.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE